



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
Kryesia

Prot 490/1

Tiranë, 20.6.2023

Vendim

Nr. 70 datë 20.06.2023

Për vazhdimin e veprimtarisë së *Institutit Kombëtar Virtual i Fizikës (IKVF)*

Referuar nenit 19 të Ligjit nr. 59/2019 *Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë;*

Në pajtim me nenin 45 të *Statutit të ASHSH;*

Me propozim të komisionit të përhershëm të fizikë-kimisë dhe Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike – SSHNT (bashkëngjitur);

Kryesia e Akademisë së Shkencave, në mbledhjen e datës 20.06.2023:

Vendosi:

1. Njësia e kërkim-studimit në fushën e fizikës, me emrin *Instituti Kombëtar Virtual i Fizikës (IKVF)*, themeluar me vendimin nr. 42 datë 05.07.2021 të Kryesisë, të vazhdojë të veprojë me të njëjtin status si në vendimin sipërcituar edhe për dy vjet të tjera, duke filluar nga data 06.07.2023.
2. IKVF të vazhdojë të veprojë në përputhje me dokumentet bazë të themelimit: akti i krijimit dhe i caktimit të bordit drejtues, miratuar me VKA nr. 42 datë 5.7.2021 dhe rregullorja e miratuar me VKA nr. 56 datë 16.9.2021. Detyrën e koordinatorit të vijojë ta kryejë dr. Olta Çakaj, sipas vendimit nr. 51 datë 3.8.2021 të Kryesisë.

3. Veprimtaria e IKVF të zhvillohet në përputhje me programin paraprak paraqitur në dokumentin bashkëngjitur, në formën e kërkesës për zgjatjen e afatit të veprimit të njësisë.
4. Brenda muajit gusht 2023 bordi drejtues të paraqesë programin përfundimtar për dy vitet në vazhdim (06.07.2023 – 06.07.2025).
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen: kryetari i SSHNT, drejtuesit e njësisë dhe kancelari.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akad. Skënder GJINUSHI

KRYETAR

